



STUDIM

PËR VLERËSIM TË GJENDJES PËR VEPRIM
NDAJ DENONCIMEVE TË DENONCUESVE
DHE TRANSPARENCËS DHE LLOGARIDHËNIES
TË NDËRMARRJEVE PUBLIKE
NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT



Instituti për Hulumtime Strategjike dhe Arsim - IHSA

STUDIM
PËR VLERËSIM TË GJENDJES PËR VEPRIM NDAJ
DENONCIMEVE TË DENONCUESVE DHE TRANSPARENCËS
DHE LLOGARIDHËNIES TË NDËRMARRJEVE PUBLIKE
NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Mars 2023, Shkup

Titulli i origjinalit: STUDIM PËR VLERËSIM TË GJENDJES PËR VEPRIM
NDAJ DENONCIMEVE TË DENONCUESVE DHE TRANSPARENCËS DHE
LLOGARIDHËNIES TË NDËRMARRJEVE PUBLIKE NË REPUBLIKËN E
MAQEDONISË SË VERIUT

Instituti për Hulumtime Strategjike dhe Arsim - IHSA

Rreth botuesit: Dr. Misho Dokmanoviq

Autorë: Dr. Darko Spasevski

Lektura: Liljana Jovanovska

Botoi: NPK „PAN„Tetovë

Tirazhi: 150 ekzemplarë

Përkthim nga gjuha maqedonase në gjuhën shqipe: Urim Kadriji

Redaktor: Dr.Misho Dokmanoviq

Ky projekt mbështetet nga Ambasada e SHBA-së. Mendimet, zbulimet dhe konkluzionet ose rekomandimet e shprehura këtu janë të implementuesve /autorëve dhe nuk pasqyrojnë ato të Qeverisë së SHBA-së.

PËRMBAJTJA

Hyrje	5
Metodologjia e hulumtimit	7
Veprimi i ndërmarrjeve publike ndaj denoncimeve të denoncuesve, praktikat kundër korrupsionit dhe transparencës dhe llogaridhënies	11
Pasqyrë e gjendjes në lidhje me disponueshmërinë e mjeteve dhe pajisjeve teknike në dispozicion të personit të autorizuar për veprim ndaj denoncimeve të denoncuesve..	12
Pasqyrë e gjendjes në aspektin e kapaciteteve njerëzore - persona të autorizuar për të vepruar në bazë të denoncimeve nga denoncuesit	16
Pasqyrë e transparencës së ndërmarrjeve publike në segmentin e mbrojtjes së denoncuesve.....	20
Pasqyrë e gjendjes në drejtim të veprimit ndaj denoncimeve nga denoncuesit	22
Marrëdhënia ndërmjet ndërmarrjes publike dhe themeluesit dhe mekanizmat e kontrollit	27
Vendosja, përzgjedhja dhe kompetencat e organeve të ndërmarrjeve publike	28
Transparenca, llogaridhënia, kontrolli dhe praktikat kundër korrupsionit të ndërmarrjeve publike	34
Marrëdhëniet e ndërsjella të ndërmarrjes publike dhe themeluesit	39
Rekomandime	47

HYRJE

Studimi për vlerësimin e gjendjes për veprim ndaj denoncimeve të denoncuesve, transparencës dhe llogaridhënies të ndërmarrjeve publike në Republikën e Maqedonisë së Veriut është përgatitur në kuadër të projektit „Nxitje të mjedisit të favorshëm për denoncim të korrupsionit në ndërmarrjet publike” i cili zbatohet nga Instituti për Hulumtime Strategjike dhe Arsim (IHSA) në periudhën nga tetori 2022 deri në shtator 2023.

Në kuadër të këtij studimi është bërë analizë e mekanizmave për pranimin dhe veprim ndaj denoncimeve të denoncuesve në kuadër të ndërmarrjeve publike të themeluara nga njësitë e vetëqeverisjes lokale në katër rajone të planifikuara, përkatësisht: Rajoni Planifikues Lindor, Rajoni Planifikues i Pellagonisë, Rajoni Planifikues i Pollogut dhe Rajoni Planifikues i Shkupit. Gjithashtu, në kuadër të hulumtimit janë analizuar edhe ndërmarrjet publike të themeluara nga shteti (Qeveria), të cilat e kanë selinë në kuadër të komunave nga njëra nga rajonet e specifikuar planifikuese të përfshira nga ky projekt.

Kur flasim për mekanizmat e pranimit dhe veprimit ndaj denoncimeve të denoncuesve, në fakt vlerësojmë zbatimin e Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve¹. Gjithashtu, hulumtimi analizon mekanizmat për transparencë dhe llogaridhënie të ndërmarrjeve publike. Transparenca dhe llogaridhënia e ndërmarrjeve publike në fakt paraqet mënyrë/mjet që denoncuesi i mundshëm të marrë informacione shtesë për denoncimin e mundshëm. Në këtë kuptim, hulumtimi kontrollon edhe zbatimin në praktikë të mekanizmave të trans-

¹ "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 196/15 dhe 35/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 257/20.

parencës dhe llogaridhënies që përfshijnë në mënyrë të barabartë ndërmarrjet publike, por dhe themeluesit e tyre. Duke pasur parasysh se analiza fokusohet edhe në Ligjin për ndërmarrjet publike ²dhe Ligjin për qasje të lirë në informatat me karakter publik ³. Krahas kësaj, analiza vlerëson bashkëpunimin dhe raportin që ekziston ndërmjet vetë ndërmarrjes publike dhe themeluesit, përmes mekanizmave të kontrollit të përcaktuar në Ligjin për ndërmarrjet publike dhe Ligjin për vetëqeverisjen lokale ⁴. Përmes lidhjes së themeluesve dhe vetë ndërmarrjeve publike synohet përdorimi i qasjes së kryqëzimit. Në të njëjtën kohë, të vlerësohet pozicioni sistematik i themeluesit kundrejt ndërmarrjes, por edhe të kontrollohet se si për të njëjtin detyrim ligjor (kompetencë) veprojnë në mënyrë të pavarur dhe të mëvetësishëm njëra nga tjetra (themeluesi dhe ndërmarrja publike).

² "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 38/96, 9/97, 6/02, 40/03, 49/06, 22/07, 83/09, 97/10, 6/12, 119/13, 41/14, 138/14, 25/ 15, 61/15, 39/16, 64/18 dhe 35/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 275/19, 89/22 dhe 274/22).

³ "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 101/19.

⁴ "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 5/02.

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Në vitet e fundit, IHSA është specializuar për zhvillimin e hulumtimeve për praktikatat kundër korrupsionit, transparencës dhe llogaridhënies në sektorit publik. Përkatësisht, për nevojat e këtij studimi janë shfrytëzuar përvojat dhe konkluzionet e konstatuara nga dy projektet e mëparshme, përkatësisht: „Organizatata civile dhe mediat në kontroll mbi punën e ndërmarrjeve publike në Rajonin Planifikues të Pollogut” (nëntor 2019 - nëntor 2020) dhe “Nxitja e aktivizimit civil për ndjekjen dhe raportimin e veprimeve të paligjshme të vetëqeverisjes lokale” (shtator 2019 – shtator 2020).

Gjatë hartimit të indikatorëve për këtë hulumtim, është marrë parasysh metodologjia e shpjeguar në „Open Government: beyond static measures [2009]”⁵. Kjo metodologji është përdorur edhe për nevojat e hulumtimeve të mëparshme. Gjithashtu, është marrë parasysh edhe Strategjia kombëtare për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit 2021-2025⁶.

Gjithashtu, gjatë definimit të indikatorëve është marrë parasysh edhe detyrimi i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut nga 28 qershori i vitit 2022, sipas të cilit të gjitha organet e administratës shtetërore janë të detyruar të përgatisin plane vjetore për vlerësimin e rreziqeve nga korrupsioni për vitin 2023. Ndonëse kjo detyrë parashikohet të zbatohet nga viti 2023 dhe nuk mbulon njësitë e vetëqeverisjes vendore, ajo është marrë parasysh sidomos gjatë hartimit të indikatorëve. Edhe pse ky detyrim ishte parashikuar të zbatohet nga viti 2023 dhe nuk i përfshinë njësitë e vetëqeverisjes, përsëri marrë parasysh posaçërisht gjatë dizajnit të indikatorëve. Në këtë drejtim me rëndësi ishte të shihet se vallë plane të tilla janë parashikuar edhe para vitit 2023, kur nuk ishte obligim i detyrueshëm në format të një lloji të praktikave të mira. Në kuadër të indikatorëve dhe gjatë përcaktimit të metodologjisë janë marrë parasysh edhe ndryshimet në Ligjin për ndërmarrjet publike nga viti 2022. Konkretisht, bëhet fjalë për dispozitat e neneve 17 deri në 17-f të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike,⁷ të cilët rregullojnë çështjet kyçe për transparencë dhe llogaridhënie në ndërmarrjen publike në drejtim të zgjedhjes së këshillit drejtues të ndërmarrjes publike dhe parashikon reduktimin e anëtarëve të këshillit drejtues. Edhe pse këto janë dispozita relativisht të reja, hulumtimi ka përfshirë edhe indikator për këto dispozita, në mënyrë që disi të inkurajohet zbatimi i duhur i tyre nga ndërmarrjet publike.

Indikatorët e mbledhur me këtë hulumtim i referohen viteve 2020, 2021 dhe 2022.

5 Disponueshme në: <https://www.oecd.org/gov/46560184.pdf>.

6 Në Strategjinë në faqen 5 vërehet mungesa e programit kundër korrupsionit në ndërmarrjet publike. Gjithashtu, në faqen 14 të Strategjisë, ndër të tjera vërehet menaxhimi dhe mbikëqyrja joeffikase e ndërmarrjeve publike. Strategjia është në dispozicion në: <https://dksk.mk/mk/%D0%BD%D0%B0%D1%86%D0%B8%D0%BE%D0%BD%D0%B0%D0%BB%D0%BD%D0%B0-%D1%81%D1%82%D1%80%D0%B0%D1%82%D0%B5%D0%B3%D0%B8%D1%98%D0%B0-2020-2024-2/>.

7 “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 89/22.

Në përgjithësi, analiza ndahet në dy pjesë:

1. Veprimi i ndërmarrjes publike pas denoncimit të denoncuesve, praktikave kundër korrupsionit dhe transparencës dhe llogaridhënies dhe
2. Marrëdhënia ndërmjet ndërmarrjes publike dhe themeluesit dhe mekanizmat e kontrollit.

Në këtë studim janë përfshirë 44 ndërmarrje publike nga të cilat janë siguruar të dhëna për 43 ndërmarrje përdërisa për 1 ndërmarrje⁸ nuk janë siguruar të dhëna. Gjithashtu, në studim janë përfshirë 19 themelues, nga të cilët janë siguruar të dhëna nga 17 themelues, ndërsa për 2⁹ themelues nuk janë siguruar të dhëna. Në Agjencinë për Mbrojtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë në Informata me Karakter Publik janë dorëzuar gjithsej 17 ankesa.

Trembëdhjetë ndërmarrje publike të analizuar janë themeluar nga shteti, përkatësisht:

1. Ndërmarrja Publike për Punë të Bursës „Agro-Berza”-Shkup;
2. Ndërmarrja Publike për Rrugët Shtetërore - Shkup;
3. N. P. për Menaxhim dhe Mbrojtje të Zonës Shumëfunktionale „Jasen” – Shkup;
4. Ndërmarrja publike për mirëmbajtje dhe mbrojtje të rrugëve kryesore dhe rajonale - Shkup;
5. NP për Menaxhimin e Pyjeve Shtetërore „Pyjet Kombëtare” - Drejtoria-Shkup;
6. NP „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” - Shkup;
7. Ndërmarrja publike për Menaxhimin e Objekteve Sportive në Pronësi të Republikës së Maqedonisë së Veriut - Shkup;
8. NP për Menaxhim të Kullosave - Shkup;
9. Ndërmarrja Publike „Strezevë” - Manastir;
10. Ndërmarrja Publike për Infrastrukturën Hekurudhore Hekurudhat e Republikës së Maqedonisë së Veriut - Shkup;
11. Ndërmarrja Publike për Menaxhimin e Ujërave „Lisiçe”-Veles;
12. Ndërmarrja Publike për Kryerjen e Aktiviteteve të Menaxhimit me Ujë Hidrosistemi „Zletovica” - Probishtip;
13. NP „Radiodifuzioni Nacional” - Shkup.

⁸Asnjë përgjigje nuk është marrë nga NP për menaxhimin e pyjeve shtetërore "Pyjet Kombëtare" - Drejtoria-Shkup.

⁹Asnjë përgjigje nuk është marrë nga Komuna e Gostivarit dhe Komuna e Bogovinës.

Ndërmarrjet e përfshira në Rajonin Planifikues Lindor

1. Ndërmarrja publike për Veprimtari Komunale „Obleshevë“-Çeshinovë-Obleshevë;
2. NP për Aktivitete Komunale Prodhuese dhe Shërbyese „ISAR“-Shtip;
3. N.P. „Stipion 2011” - Shtip dhe
4. Ndërmarrja Publike për Punë Komunale „Solidariteti“-Vinicë.

Si themelues të ndërmarrjeve publike në Rajonin Planifikues Lindor: Komuna e Vinicës, Komuna e Shtipit dhe Komuna e Çeshinovës Obleshevës.

Ndërmarrjet e përfshira në Rajonin Planifikues të Pellagonisë

1. N. P. K Ujësjiellës dhe Kanalizim – Prilep;
2. Ndërmarrja Publike Komunale „Komunalec“-Prilep;
3. Ndërmarrja Publike „Pazari“-Prilep;
4. Ndërmarrja Publike „Pazari” - Manastir;
5. Ndërmarrja Publike për Plane Hapësinore dhe Urbanistike Prilep;
6. NPK „Vodovod” - Manastir dhe
7. NPK Pella Higjiena - Mogila.

Këta janë themeluesit e ndërmarrjeve publike në rajonin Planifikues të Pellagonisë: Komuna e Manastirit, Komuna e Prilepit dhe Komuna e Mogilës.

Ndërmarrjet e përfshira në Rajonin Planifikues të Pollogut

1. Ndërmarrja Publike „Mavrovë “ - Mavrovi Anovi ;
2. Ndërmarrja Publike për Parkingje Publike Gradski Parking-Tetovë;
3. Ndërmarrja Publike „Shari” – fsh. Bogovinjë
4. NPK Tetovë;
5. Ndërmarrja Publike Komunale „Vardar“-Bërvenicë;
6. NPK „Vrapçisht“-Vrapçisht;
7. Ndërmarrja Publike Komunale „Vardar“-Bërvenicë i
8. Ndërmarrja Publike për Menaxhimin e Sallës Sportive „Rinia” - Gostivar

Këta janë themeluesit e ndërmarrjeve publike në Rajonin Planifikues të Pollogut: Komuna e Mavrovës Rostushë, Komuna e Gostivarit, Komuna e Tetovës, Komuna e Vrapçishtit, Komuna e Bogovinës dhe Komuna e Bërvenicës.

Ndërmarrjet e përfshira në Rajonin Planifikues të Shkupit

1. Ndërmarrja Publike për Deponimin e Mbeturinave Komunale "Drisla"-Shkup;
2. NP „City Parking”-Shkup;
3. NP „Rrugicat dhe rrugët”-Shkup;
4. Kompania e transportit publik “Shkupi”,
5. NP „Parqe dhe Gjelbërim” – Shkup;
6. NP „Shkupi Vjetër”-Shkup;
7. Ndërmarrja Publike për Parkingje Publike Parkingjet e Komunës Qendër;
8. Ndërmarrja Publike „Vodovod”-lagj. Ilinden;
9. Ndërmarrja Publike „Ilinden” - Komuna e Ilindenit;
10. Ndërmarrja Publike „Saraj”-Shkup;
11. Ndërmarrja Publike „Sopishte” - fsh. Sopishte dhe
12. NPK “GAZI BABA-2007”-Shkup.

Si themelues të ndërmarrjeve publike në Rajonin Planifikues të Shkupit: paraqiten: Qyteti i Shkupit, Komuna Qendër, Komuna e Sarajit, Komuna e Ilindenit, Komuna e Çairit, Komuna e Gazi Babës dhe Komuna e Sopishtës.

VEPRIMI I NDËRMARRJEVE PUBLIKE NDAJ DENONCIMEVE TË DENON- CUESVE, PRAKTIKAT KUNDËR KORRUPSIONIT DHE TRANSPARENÇËS DHE LLOGARIDHËNIES

Në kuadër të pjesës së parë të analizës, kryhet matja dhe vlerësimi i zbatimit në praktikë të Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve. Krahas kësaj, dhe duke marrë parasysh rëndësinë e Ligjit për qasje të lirë të informatat me karakter publik, në këtë pjesë është përfshirë edhe një indikator i posaçëm që i referohet zbatimit në praktikë të nenit 10 të Ligjit për qasje të lirë të informatat me karakter publik ¹⁰. Kjo pjesë e studimit përbëhet nga njësitë e mëposhtme:

Pasqyrë e situatës në lidhje me disponueshmërinë e mjeteve dhe pajisjeve teknike në dispozicion të personit të autorizuar për të vepruar sipas denoncimeve të denoncuesve,

Pasqyrë e gjendjes në aspektin e kapaciteteve njerëzore - personat e autorizuar për veprim sipas denoncimeve të denoncuesve,

Pasqyrë e transparencës së ndërmarrjeve publike në segmentin e mbrojtjes së denoncuesve dhe

Pasqyrë e situatës në drejtim të veprimit ndaj denoncimeve nga denoncuesit.

¹⁰ Në bazë të nenit 10. (1) Poseduesi i informatave është i detyruar ta njoftojë publikun nëpërmjet internet faqes së vet me publikimin e: të dhënave nga kompetencat e veta të cilat i kryen, përkatësisht i janë përcaktuar me ligj, të dhënave themelore për kontakt me poseduesin e informatës edhe atë: emrit, adresës, numrit të telefonit, numrit të faksit, e-mail adresës dhe adresës së faqes së internetit, të dhënave për funksionarin ose personin përgjegjës të poseduesit i informatës (biografi, të dhëna për kontakt etj.), të dhënave themelore për kontakt me personin zyrtar për ndërmjetësim me informata, edhe atë: emri dhe mbiemri, e-mail adresa dhe numrit i telefonit, të dhënave themelore për kontakt me personin e autorizuar për paraqitje të brendshme të mbrojtur, edhe atë: emrin dhe mbiemrin, e-mail adresën dhe numrin e telefonit, listës së personave të punësuar të poseduesit i informatës me pozitë, e-mailit zyrtar dhe telefonit zyrtar, ligjeve të cilat kanë të bëjnë me kompetencën e poseduesit të informatave, lidhur me regjistrin e rregullave të publikuara në gazetën zyrtare, rregullave që në kuadër të kompetencës së vet i miraton poseduesi i informatës në llogj të aktit nënligjor: rregulloreve (rregullore për organizim të brendshëm, rregullore për sistematizimin e vendeve të punës, rregullore për paraqitje të brendshme të mbrojtur etj.), dekrete, urdhëresa, udhëzime, plane, programe, aktvendime dhe lloje tjera të akteve për realizimin e ligjeve dhe rregullave tjera, kur për atë janë të autorizuar me ligj, organogramit për organizim të brendshëm, planeve strategjike dhe strategjive për punë të poseduesve të informatave, planeve vjetore dhe programeve për punë, Buxhetit vjetor dhe llogarisë përfundimtare, planeve vjetore financiare sipas tremujorëve dhe programeve për realizimin e buxhetit, raportit të revizorit, llojeve të shërbimeve të cilat i japin poseduesit e informatave (informata për qasjen fizike për realizimin e shërbimeve dhe informatave për e-shërbimet, të dhënat për bazat ligjore, emrin e shërbimeve, dokumentet dhe të dhënat e nevojshme për realizimin e secilit shërbim, mekanizmat për mbrojtje juridike dhe të dhëna tjera relevante), listave tarifore për kompensimet për lëshimin e akteve reale, mënyrën e parashtrimit të kërkesës për qasje të informatat (mënyra e parashtrimit e kërkesës me gojë dhe me shkrim për qasje të informatat, si dhe kërkesë e parashtruar në formë elektronike), dokumentacionit të plotë për prokurimet publike, për koncesionet dhe për marrëveshjet për partneritet privat-publik, propozim – programeve, programeve, qëndrimeve, mendimeve, studimeve dhe dokumenteve tjera të ngjashme të cilat kanë të bëjnë me aktet nga kompetenca e poseduesit të informatave njoftimeve për publikun për punë e ndërmarrja nga internet faqja e tyre në pajtim me kompetencat ligjore, buletine informative, gazeta zyrtare nëse janë obligim në pajtim me ligj e të tjera, raporteve për punë të cilat i parashtrorjnë të organet kompetente për zbatimin e kontrollit dhe mbikëqyrjes, të dhënave statistikore për punën, si dhe informatave tjera, akteve dhe masave me të cilat ndikohet mbi jetën dhe punën e qytetarëve dhe të cilat dalin nga kompetenca dhe puna e poseduesit të informatave dhe informatave tjera të cilat dalin nga kompetenca dhe puna e poseduesit të informatës.

PASQYRË E GJENDJES NË LIDHJE ME DISPONUESHMËRINË E MJETEVE DHE PAJISJEVE TEKNIKE NË DISPOZICION TË PERSONIT TË AUTORIZUAR PËR VEPRIM NDAJ DENONCIMEVE TË DENONCUESVE

Me qëllim të ndërtimit të sistemit efikas për pranimin dhe veprimin ndaj denoncimeve të denoncuesve, është e nevojshme të sigurohen burime adekuate për punë për personat që veprojnë në bazë të denoncimeve nga denoncuesit. Burimet e punës duhet të jenë të mjaftueshme për kryerjen e suksesshme dhe efektive të punës së këtyre personave. Kushtet themelore teknike dhe burimet që duhet të jenë në dispozicion të personave të cilët veprojnë në batë të denoncimeve nga denoncuesit përcaktohen me Rregulloren për denoncim të brendshëm të mbrojtur në institucionet në sektorin publik (në tekstin e mëtejshëm "Rregullore").¹¹Në përputhje me nenin 4 [1] të Rregullores, personi udhëheqës i siguron pavarësinë dhe qetësinë e punës personit të autorizuar. Në këtë kuptim, për të siguruar fshehtësinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale dhe të të dhënave të tjera të marra dhe të përpunuara nga personi i autorizuar, personi udhëheqës, në përputhje me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale dhe dispozitat për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuar, siguron dhe zbaton masat e duhura teknike dhe organizative për të mbrojtur të dhënat nga shkatërrimi i tyre aksidental ose i paligjshëm, ose humbja aksidentale, falsifikimi, zbulimi ose qasja e paautorizuar e tyre, veçanërisht kur përpunimi përfshin transferimin e të dhënave përmes rrjetit dhe mbrojtjen kundër çdo forme të paligjshme të përpunimit. Ajo që është më e rëndësishme dhe për sa i përket kushteve teknike për punë, në përputhje me nenin 4 [3] të Rregullores, udhëheqësi i siguron personit të autorizuar hapësirë dhe pajisje për punë:

Hapësirë pune e përshtatshme për pranimin e palëve;

kompjuter të veçantë të pajisur me emër përdoruesi dhe fjalëkalim unik të krijuar nga personi i autorizuar dhe i njohur vetëm për të, me lidhje interneti dhe kuti të veçantë postare elektronike të pajisur me emër përdoruesi dhe fjalëkalim unik të krijuar nga personi i autorizuar dhe i njohur vetëm për të;

- vulë të veçantë për pranim;
- libër të veçantë për regjistrim;
- kuti postare të veçantë;
- linjë telefonike të veçantë;
- Dollap të veçantë për ruajtjen e sigurt të denoncimeve të pranuar, procesverbalet, dokumentet e pranuar dhe të krijuara dhe materialet tjera që kanë të bëjnë me denoncimin e jashtëm të mbrojtur, librin e veçantë për regjistrim dhe vulën e pranimit;

¹¹Gazeta Zyrtare e RM, nr. 46, datë 03.08.2016

- pajisje të tjera për zbatimin e masave teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të të dhënave të tjera të cilët kanë të bëjnë me denoncuesit dhe denoncimet, duke marrë parasysh dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale dhe dispozitat për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara.

Në kuadër të këtij studimi janë siguruar të dhëna që i referohen vlerësimit të burimeve në dispozicion dhe nevojave teknike të personave të autorizuar që veprojnë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e denoncuesve.

Tabela 1:

Sigurim i hapësirës së veçantë		
kanë siguruar hapësirë të veçantë	nuk kanë siguruar hapësirë të veçantë	nuk kanë dhanë përgjigje
15.9%	79.6%	4.5%

Sigurohet hapësirë e veçantë	1 ndërmarrje publike nuk ka dorëzuar përgjigje
	7 ndërmarrje publike kanë siguruar
	36 ndërmarrje publike nuk kanë siguruar

Tabela 2:

Kompjuter të veçantë të pajisur me emër përdoruesi dhe fjalëkalim unik të krijuar nga personi i autorizuar dhe i njohur vetëm për të, me lidhje interneti dhe kuti postare elektronike të veçantë të pajisur me emër përdoruesi dhe fjalëkalim unik të krijuar nga personi i autorizuar dhe i njohur vetëm për të.	1 ndërmarrje publike nuk ka dorëzuar përgjigje
	11 ndërmarrje publike kanë siguruar
	32 ndërmarrje publike nuk kanë siguruar

Tabela 3:

Vulë të veçantë për pranim	1 ndërmarrje publike nuk ka dorëzuar përgjigje
	4 ndërmarrje publike kanë siguruar
	39 ndërmarrje publike nuk kanë siguruar

Tabela 4:

Libër të veçantë për regjistrim	1 ndërmarrje publike nuk ka dorëzuar përgjigje
	5 ndërmarrje publike kanë siguruar
	38 ndërmarrje publike nuk kanë siguruar

Tabela 5:

Kuti postare të veçantë	1 ndërmarrje publike nuk ka dorëzuar përgjigje
	8 ndërmarrje publike kanë siguruar
	35 ndërmarrje publike nuk kanë siguruar

Tabela 6:

Linjë telefonike të veçantë	1 ndërmarrje publike nuk ka dorëzuar përgjigje
	7 ndërmarrje publike kanë siguruar
	36 ndërmarrje publike nuk kanë siguruar

Tabela 7:

Dollap të veçantë për ruajtjen e sigurt të denoncimeve të pranuar, procesverbalet, dokumentet e pranuar dhe të krijuara dhe materialet tjera që kanë të bëjnë me denoncimin e jashtëm të mbrojtur, librin e veçantë për regjistrim dhe vulën e pranimit;	1 ndërmarrje publike nuk ka dorëzuar përgjigje
	6 ndërmarrje publike kanë siguruar
	37 ndërmarrje publike nuk kanë siguruar

Tabela 8:

Pajisje të tjera për zbatimin e masave teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të të dhënave të tjera të cilët kanë të bëjnë me denoncuesit dhe denoncimet, duke marrë parasysh dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale dhe dispozitat për mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara.	1 ndërmarrje publike nuk ka dorëzuar përgjigje
	5 ndërmarrje publike kanë siguruar
	38 ndërmarrje publike nuk kanë siguruar

KONKLuzion

Konkluzioni i përgjithshëm në lidhje me burimet teknike në dispozicion të personit të autorizuar për veprim ndaj denoncimeve të denoncuesve në ndërmarrjet që kanë qenë objekt i këtij hulumtimi është se burimet në shumicën e ndërmarrjeve nuk janë siguruar në përputhje me Rregulloren. Nga analiza e gjithsej 44 ndërmarrjeve publike vetëm:

- 7 siguruan hapësirë të veçantë (tabela 1),
- 11 siguruan kompjuter të veçantë (tabela 2),
- 4 siguruan vulë të veçantë (tabela 3),
- 5 siguruan libër të veçantë për regjistrim (tabela 4),
- 8 siguruan kuti postare të veçantë (tabela 5),
- 7 siguruan linjë telefonike të veçantë (tabela 6),
- 6 siguruan dollap të veçantë për dokumente (tabela 7) dhe
- 5 siguruan pajisje shtesë në përputhje me Rregulloren (tabela 8)

PASQYRË E GJENDJES NË ASPEKTIN E KAPACITETEVE NJERËZORE - PERSONA TË AUTORIZUAR PËR TË VEPRUAR NË BAZË TË DENONCIMEVE NGA DENONCUESIT

Në bazë të nenit 4 [1] të Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve, denoncim të mbrojtur, denoncuesi kryen në institucion, përkatësisht personin juridik, ku ka dyshime ose dijeni se është kryer, po kryhet ose do të kryhet vepër penale. të kryhet ose vepër tjetër e paligjshme ose e palejueshme, sjellje që dëmton ose kërcënon interesin publik.

Denoncimi i mbrojtur është lëndë e personit të autorizuar për pranimin e denoncimeve nga denoncuesit, nëse nuk ka person të tillë të caktuar në përputhje me nenin 4 [3] të Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve, denoncimi i brendshëm i mbrojtur i kryhet personit udhëheqës të institucionit, përkatësisht personit juridik në rastin konkret ndërmarrjes publike.

Personi i autorizuar për pranim të denoncimeve nga denoncuesit, gjegjësisht personi udhëheqës në institucion, gjegjësisht personi juridik, është i detyruar që:

- të veprojë në bazë të denoncimeve në përputhje me procedurat e përcaktuara me aktin e brendshëm të denoncimit;
- të mbrojë të dhënat personale të denoncuesit, përkatësisht të dhënat që mund të zbulojnë identitetin e denoncuesit që denoncon në mënyrë anonime ose konfidenciale, në përputhje me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale;
- të informojë denoncuesin i cili është i njoftuar për masat e ndërmarra në lidhje me denoncimin pa vonesë dhe më së voni në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të denoncimit.

Kushtet e përgjithshme të përcaktuara në Ligjin për mbrojtjen e denoncuesve janë funksionalizuar hollësisht me Rregulloren.

Në bazë të nenit 2 [2] të Rregullores, nga ana e personit udhëheqës mund të emërohen më shumë persona të autorizuar, duke përcaktuar se cili prej tyre është përgjegjës për mbledhjen e të dhënave dhe për përgatitjen dhe dorëzimin e raportit gjashtëmujor mbi denoncimet e pranuar nga denoncuesit.

Bazuar në nenin 2 [3] të Rregullores, në institucionet ku nuk ka person të autorizuar, denoncimi i brendshëm i mbrojtur i bëhet personit udhëheqës.

Në nenin 4 [4] të Rregullores përcaktohet se personi udhëheqës përshkruan procedurat e brendshme për pranimin e denoncimeve nga denoncuesit, ndarjen dhe përpunimin e të dhënave nga denoncimet dhe ndërmerr masa për sigurimin e mbrojtjes së të dhënave personale dhe të të dhënave të tjera në lidhje me dorëzimin e denoncimeve nga

denoncuesit, duke zbatuar dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale dhe mbrojtjen e informacioneve të klasifikuara. Sipas prezantimit, tri akte të ndryshme, të riradhitura në mënyrë hierarkike, duke filluar me Ligjin për mbrojtjen e denoncuesve, pastaj Rregulloren për denoncimin e brendshëm të mbrojtur në institucionet e sektorit publik (që rrjedhin nga ligji) dhe në fund procedurat e brendshme. (në bazë të nenit 4 [4] të Rregullores) rregullojnë çështjet me interes për hulumtimin tonë.

Në nenin 3 të Rregullores përcaktohen kushtet që duhet t'i plotësojë personi i autorizuar për të vepruar ndaj denoncimeve nga denoncuesit. Prandaj, personi i autorizuar duhet të plotësojë këto kushte:

- të jetë person i punësuar në pozitën udhëheqëse;
- të ketë të përfunduar arsimin e lartë në fushën e shkencave juridike, të sigurisë ose ekonomike;
- të posedon certifikatë sigurie në varësi të shkallës së klasifikimit të informacionit që disponon institucioni për të cilin personi është emëruar;
- të ketë përvojë pune në trajtimin për veprim ndaj denoncimeve, gjegjësisht ndaj parashtrësve, punës me palë, kryerjes së mbikëqyrjes, ndërmarrjes së veprimeve hetimore gjegjësisht kryerje të revizionit ose kontrollit të brendshëm ose përvojë tjetër pune në kryerjen e detyrave të konfidencialitetit, marrjen dhe dërgimin e të dhënave në institucionet e tjera dhe drejtimin e palëve .

Tabela 9:

Në ndërmarrjen publike, detyrimet nga Ligji për mbrojtjen e denoncuesve për pranimin dhe veprimin e denoncimeve për korrupsion, kryhen nga personi udhëheqës apo është caktuar person i autorizuar për pranimin e denoncimeve?	1 kompani publike nuk ka dërguar përgjigje
	19 ndërmarrje publike kanë person të autorizuar të veçantë
	9 ndërmarrje publike udhëhiqen nga personi udhëheqës
	15 ndërmarrje publike nuk e kanë caktuar

Tabela 10:

A ka paraparë ndërmarrja publike (akte të miratuara) për përcaktimin e procedurave të brendshme për pranimin e denoncimeve nga denoncuesit, ndarjen dhe përpunimin e të dhënave nga denoncimet dhe ndërmarrjen e masave për të siguruar mbrojtjen e të dhënave personale dhe të dhe të dhënave tjera në lidhje me denoncuesit dhe denoncimet nga denoncuesit?	1 kompani publike nuk ka dorëzuar përgjigje
	26 ndërmarrje publike nuk kanë akte të veçanta të brendshme
	2 ndërmarrje publike janë thirrur në akte të përgjithshme
	15 ndërmarrje publike kanë akte të brendshme të veçanta

Tabela 11:

Sa trajnime ka ndjekur personi i autorizuar për të pranimin e denoncimeve nga denoncuesit gjatë periudhës për të cilën ka qenë i autorizuar të veprojë sipas denoncimeve?	1 ndërmarrje publike nuk ka dorëzuar përgjigje
	6 ndërmarrje publike kanë pasur gjithsej 14 trajnime në një periudhë trevjeçare
	37 ndërmarrje publike nuk kanë pasur trajnime

Tabela 12

Kush i financon trajnimet në të cilën ka marrë pjesë personi i autorizuar për të pranimin e denoncimeve (tarifa për pjesëmarrje në trajnim mbulohet nga institucioni juaj apo mbulohet nga palët e treta (organizatori i trajnimit, donatori, etj.))? Shënim: informacionet janë dhënë vetëm për ndërmarrjet publike që kanë pasur trajnime	1 ndërmarrje publike nuk ka dorëzuar përgjigje
	5 ndërmarrje publike vetë i kanë financuar trajnimet
	1 ndërmarrje publike ka marrë pjesë në trajnim përmes donatorit (USAID)

Tabela 13:

A ka ndonjë kompensim shtesë përveç pagës për angazhimin e personit të autorizuar për të vepruar sipas denoncimeve nga denoncuesit dhe sa është ai kompensim në nivel vjetor?	1 kompani publike nuk ka dorëzuar përgjigje
	43 ndërmarrje publike nuk kanë parashikuar kompensim

KONKLUZION

Gjatë analizës së kapaciteteve të vendosjes dhe organizimit të burimeve njerëzore për veprim ndaj denoncimeve të denoncuesve vihet re nivel mesatar i përmbushjes dhe zbatimit të dispozitave ligjore. Prandaj, 19 ndërmarrje publike kanë person të caktuar për pranimin e denoncimeve dhe në 9 ndërmarrje këtë e kryen personi udhëheqës. Kjo është gjithsej 28 ndërmarrje ose më shumë se gjysma e ndërmarrjeve të analizuara. Gjithashtu, pjesa tjetër e indikatorëve tregojnë nivel të ulët të përmbushjes, ku:

26 ndërmarrje publike nuk kanë akte të brendshme për procedurat (tabela 10);

vetëm 6 ndërmarrje publike kanë pasur trajnime për personat e autorizuar (tabela 11). Është interesant fakti se në një periudhë trevjeçare janë organizuar vetëm 14 trajnime;

5 ndërmarrje publike kanë financuar në mënyrë të pavarur trajnimet, dhe 1 ndërmarrje publike përmes donatorëve (tabela 12), dhe

Asnjë nga ndërmarrjet publike që kanë dorëzuar të dhënat nuk parashikon tarifë shtesë të veçantë për personin e autorizuar (tabela 13).

PASQYRË E TRANSPARENÇËS SË NDËRMARRJEVE PUBLIKE NË SEGMENTIN E MBROJTJES SË DENONCUESVE

Me qëllim arritjen e transparencës, dy dispozita të Rregullores janë me interes, përkatësisht neni 5 [6], sipas të cilit personi udhëheqës dorëzon në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit këto të dhëna: emrin dhe mbiemrin; vendin e punës; numrin e telefonit kontaktues; adresën postare dhe adresën e e-mail për pranimin e denoncimeve, si dhe nenin 5 [6] të Rregullores sipas të cilit të dhënat e personit të autorizuar publikohen të plota në faqen e internetit të institucionit në të cilin është emëruar personi i autorizuar ose në një mënyrë tjetër janë vënë në dispozicion të publikut.

Tabela 14:

A janë publikuar në faqen tuaj të internetit të dhënat e kontaktit të personit/personave të autorizuar për të vepruar në bazë të denoncimeve nga denoncuesit ?	1 ndërmarrje publike nuk ka dorëzuar përgjigje
	19 ndërmarrje publike kanë publikuar
	24 ndërmarrje publike nuk kanë publikuar

Neni 15 [1] i Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve, parashikon detyrimin që personat e autorizuar përkatësisht udhëheqësit e institucioneve përkatësisht personat juridik në sektorin publik të cilët denoncohen janë të obliguar të dorëzojnë raporte gjysmë vjetore për denoncimet e pranuar nga denoncuesit në Komisionin shtetëror për parandalimin e korrupsionit.

Ky raport, gjegjësisht volumi dhe struktura e tij, më hollësisht janë shtjelluar në Rregulloren në nenin 13. Në përgjithësi, në pajtim me nenin 13 [1] të Rregullores, personi i autorizuar përgatit raport gjashtëmuor për raportet e pranuar nga denoncuesit, i cili përmban të dhëna të përgjithshme statistikore dhe të dhëna për rastet e konstatuara sipas denoncimeve të pranuar. Në paragrafin [2] të këtij neni më hollësisht është rregulluar lloji i të dhënave statistikore që duhet të përfshihen në raport.

Paragrafi [3] i këtij neni përmban të dhëna thelbësore, të cilat mund të kenë përdorim më të gjerë, si për opinionin ekspert kritik, për mediat, ashtu edhe për publikun e gjerë. Pra, në përputhje me këtë dispozitë ligjore, raporti përmban të dhëna për: numrin e përgjithshëm të denoncimeve të pranuar; numrin e denoncimeve të pranuar sipas parametrave: formën dhe mënyrën e dorëzimit të raportit (me gojë, me postë, me e-mail), denoncim penal, gjegjësisht veprim të palejueshëm, kategorinë e personave në cilësinë e denoncuesit, pozita/ vendi i punës së personave të denoncuar, denoncues konfidencialë,

denoncues anonimë, denoncues jo anonimë që nuk kanë kërkuar të jenë konfidenciale; numrin e përgjithshëm të denoncuesve të cilët kanë dorëzuar denoncime në bazë të cilëve janë formuar lëndë; numrin e denoncuesve anonimë të cilët kanë dorëzuar raporte në bazë të cilëve janë formuar lëndë; numri i denoncimeve konfidencialë dorëzuar denoncime në bazë të cilëve janë formuar lëndë; numrin e lëndëve të formuara sipas denoncimeve të pranuar; masat e ndërmarra për veprimin ndaj denoncimeve të pranuar; dhe statusin e lëndëve të formuara sipas denoncimeve të pranuar dhe rezultatin e trajtimit të lëndëve.

Tabela 15:

A dorëzon ndërmarrja publike raporte gjashtë mujore për denoncimet e pranuar nga denoncuesit në Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e denoncuesve për periudhën 2020-2022?	1 ndërmarrje publike nuk ka dorëzuar përgjigje
	7 ndërmarrje publike kanë dorëzuar raporte
	36 ndërmarrje publike nuk kanë dorëzuar raporte

KONKLUZION

Për sa i përket transparencës dhe disponueshmërisë të informacioneve për personin e autorizuar për pranimin e denoncimeve dhe informacioneve për veprimin ndaj denoncimeve përmes raporteve, konstatohet se edhe ky segment i analizës është në nivel të ulët. Gjegjësisht, vetëm 19 ndërmarrje publike kanë të dhëna në dispozicion në ueb faqen e tyre për personin e autorizuar për të pranuar denoncime nga denoncuesit (tabela 14) dhe vetëm 7 ndërmarrje dorëzojnë raporte nga KSHPK-ja (tabela 15). Analiza plotësuese e të dhënave, në pjesën tekstuale, tregon se një pjesë e madhe e ndërmarrjeve publike nuk kanë ueb faqe të tyre, kështu që kjo është arsyeja e nivelit të ulët të publikimit të të dhënave për personin e autorizuar. Gjithashtu, një pjesë e madhe e ndërmarrjeve që nuk kanë dorëzuar raporte, e bazojnë në konstatimin se nuk kanë pranuar denoncime nga denoncuesit.

PASQYRË E GJENDJES NË DREJTIM TË VEPRIMIT NDAJ DENONCIMEVE NGA DENONCUESIT

Sipas nenit 2 [1] të Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve, si denoncim i mbrojtur në kuptimin e këtij ligji është denoncimi respektivisht zbulimi me të cilin në pajtim me këtë ligj bartet dyshimi racional ose kuptimi se është kryer, kryhet ose është e sigurt se do të kryhet veprim i ndëshkueshëm, joetik apo veprim tjetër joligjor ose i palejuar me të cilin shkelet ose cenohet interesi publik.

Neni 2 [3] i Ligjit përcakton kategoritë e personave në cilësi të denoncuesve, përkatësisht:

- personi i cili ka themeluar marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar ose të caktuar në institucionin respektivisht personin juridik për ku denoncon;
- kandidati për punësim, kandidat për vullnetar ose praktikant në institucion respektivisht person juridik për ku denoncon;
- personi i cili është ose do ka qenë vullnetar ose praktikant në institucion respektivisht person juridik për ku denoncon;
- personi i cili në çfarëdo baze është ose ka qenë i angazhuar për realizimin e punës nga institucioni respektivisht personi juridik për ku denoncon;
- personi i cili në çfarëdo baze është ose ka qenë në marrëdhënie afariste ose marrëdhënie tjetër në bashkëpunim me institucionin respektivisht personin juridik për ku denoncon;

Baza për veprimet e ndërmarrjeve publike sipas Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve gjendet në nenin 2 [4] të ligjit, sipas të cilit „me nocionin institucion në kuptim të këtij ligji nënkuptohet.....ose ndërmarrje publike e themeluar nga Republika e Maqedonisë ose nga komuna, Qyteti i Shkupit dhe komuna në Qytetin e Shkupit,”

Në kuadër të analizës, objekt interesi është denoncimi i mbrojtur, i përcaktuar në nenin 4 të Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve si denoncim të mbrojtur denoncuesi kryen në institucionin, respektivisht personin juridik, për ku ka dyshim ose kuptim se është kryer, kryhet ose do të kryhet ose vepër e ndëshkueshme, ose veprim tjetër joligjor ose i palejuar, me të cilin shkelet ose cenohet interesi publik.

Denoncimet nga denoncuesi te personi i autorizuar mund të dorëzohen individualisht ose në grup, në formë të shkruar të dorëzuar personalisht ose nëpërmjet kutisë postare të veçantë ose kutisë postare elektronike, ose gojarisht në procesverbal.

Në nenin 6 të Rregullores është përcaktuar veprimi në bazë të denoncimit me gojë për të cilat personi i autorizuar përgatit procesverbal. Në të njëjtën dispozitë të Rregullores është përcaktuar edhe përmbajtja e procesverbalit.

Në përputhje me nenin 7 të Rregullores, nëse denoncimi dorëzohet në formë elektronike në bartësin e regjistrimit elektronik, përkatësisht në mënyrë elektronike, personi i autorizuar printon shkresën që i përgjigjet denoncimit sipas përmbajtjes dhe atë të shtypur me bashkëngjitjet e listuara të pranuar në formën e të dhënave elektronike të regjistruar si denoncim i pranuar.

Neni 9 [1] i Rregullores përcakton se, pas pranimit dhe regjistrimit të denoncimit, personi i autorizuar vlerëson pa vonesë përmbajtjen e denoncimit për të përcaktuar nëse ai është i logjikshëm dhe i arsyeshëm, nëse paraqet denoncim nga denoncuesi në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e denoncuesve si dhe nëse denoncimi përmban elementë të mjaftueshme për veprim të mëtejshëm.

Neni 11 [2] i Rregullores përcakton se nëse është denoncuar veprë penale krim kundër shtetit, kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare, në fushën e krimit të organizuar dhe për të cilin Kodi Penal parasheh dënim me burg prej së paku katër vjet, dëshmi e të cilit është pasuar nga vështirësi jo proporcionale ose nuk mund të kryhet pa dëshminë e denoncuesit i cili, për shkak të rrezikut të mundshëm për t'u ekspozuar ndaj frikësimit, kërcënimit për hakmarrje ose rrezikut për jetën, shëndetin, lirinë, integritetin fizik ose pronën me përmasa më të mëdha, nuk pajtohet si dëshmitar të japë deklaratë, personi i autorizuar me pëlqimin me shkrim të marrë nga denoncuesi pa vonesë dorëzon: - në Ministrinë e Punëve të Brendshme ose Prokurorit publik kompetentë iniciativë për paraqitjen e kërkesës me shkrim për paraqitjen e propozimit për përfshirje në Programin e mbrojtjes në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e dëshmitarëve ose - iniciativë të Prokurorit publik për dorëzimin e Propozimit për përfshirje në programin e mbrojtjes në pajtim me Ligjin për mbrojtjen e dëshmitarëve.

Gjithashtu, në nenin 12 të Rregullores, parashikohet që pas pranimit të denoncimit që dërgohet në institucionin kompetent për të cilin pas vlerësimit konstatohet se i njëjti është i logjikshëm, i arsyeshëm dhe i përmban elementet e mjaftueshme për veprime të mëtejshme, personi i autorizuar ndërmerri masa në kompetencën e tij për veprim ndaj denoncimit, gjegjësisht e përcjell denoncimin zyrtarit në institucionin përgjegjës për trajtimin e fushës të cilës i referohet denoncimi, pasi t'i ketë ndarë paraprakisht të dhënat personale dhe të dhënat që mund të zbulojnë identitetin e denoncuesit nëse denoncuesi kërkon të mbetet i besueshëm.

Tabela 16:

Sa denoncime të brendshme ka pranuar institucioni juaj veçmas në vitin 2022, 2021 dhe 2020 në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e denoncuesve?	1 ndërmarrje publike nuk ka dorëzuar përgjigje
	3 ndërmarrje publike kanë denoncime ¹²
	40 ndërmarrje publike nuk kanë denoncime

Tabela 17:

Në ndërmarrjen publike a është i njoftuar parashtruesi për veprimin ndaj denoncimit në përputhje me afatin ligjor ndërsa më së voni në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të denoncimit?	1 ndërmarrje publike nuk ka dorëzuar përgjigje
	3 ndërmarrje publike është njoftuar
	40 ndërmarrje publike nuk kanë denoncime

Tabela 18:

Sa nga denoncimet e parashtruara janë formuarë lëndë dhe denoncimet janë dorëzuar nën kompetencë institucioneve përkatëse kompetente për veprim mbi to? [në këtë indikator janë përfshirë vetëm ndërmarrjet të cilat kanë pranuar denoncime nga denoncuesit]	1 ndërmarrje publike nuk ka dorëzuar përgjigje
	1 ndërmarrje publike ka dorëzuar brenda sektorit të ndërmarrjes
	2 ndërmarrje publike nuk kanë dërguar më tej

Tabela 19:

Në cilat institucione kompetente janë dorëzuar denoncimet nga denoncuesit të pranuar në ndërmarrjen publike?	1 ndërmarrje publike nuk ka dorëzuar përgjigje
	Nuk ka dorëzim të tillë në asnjërën ndërmarrje

¹²Ndërmarrja Qarkulluese Publike Shkup ka pranuar 27 denoncime, Ndërmarrja Publike për Rrugët Shtetërore ka pranuar një denoncim, por në vitin 2019 edhe N.P për Menaxhim dhe Mbrojtje të Zonës Shumë Funktionale „Jasen“ – Shkup ka pranuar një denoncim.

Tabela 20:

A është bërë denoncim i jashtëm i mbrojtur për çështje që lidhen me institucionin tuaj në përputhje me nenin 5 të Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve veçmas në vitin 2016, 2017 dhe 2018?	1 ndërmarrje publike nuk ka dorëzuar përgjigje
	1 ndërmarrje publike posedon
	42 ndërmarrje publike nuk posedojnë

Tabela 21:

A është kryer procedurë për mbikëqyrje nga Ministria e Drejtësisë në përputhje me nenin 15-a të Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve në ndërmarrjen publike?	1 ndërmarrje publike nuk ka dorëzuar përgjigje
	43 ndërmarrje publike nuk kanë qenë subjekt të mbikëqyrjes

Tabela 22:

A është gjobitur kompania publike në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e denoncuesve?	1 ndërmarrje publike nuk ka dorëzuar përgjigje
	43 ndërmarrje publike nuk ju është shqiptuar gjobë

Tabela 23:

A ka organizuar ndërmarrja publike trajnime për të punësuarit e saj apo për persona të tjerë për t'i njoftuar me të drejtat e tyre nga Ligji për mbrojtjen e denoncuesve në drejtim të mund të denoncojnë parregullsi në përputhje me këtë Ligj?	1 ndërmarrje publike nuk ka dorëzuar përgjigje
	6 ndërmarrje publike kanë organizuar trajnime
	37 ndërmarrje publike nuk kanë organizuar trajnime

KONKLUZION

Numri i denoncimeve të pranuar, si dhe numri i ndërmarrjeve që kanë marrë denoncime, tregon se koncepti i denoncimeve është në nivel të ulët të zbatimit. Vetë fakti se vetëm 3 ndërmarrje publike kanë pranuar denoncime në periudhën trevjeçare të analizës (tabela 16) është e palogjikshme nëse merret parasysh se sipas një numri të madh të analizave dhe raporteve, shkalla e korrupsionit në Republikën e Maqedonisë së Veriut është në një nivel relativisht të lartë ¹³. Prandaj lind pyetja se pse numri i denoncimeve është i ulët. Njëherit, shpjegimi tregon se ka munguar besimi besim tek institucionet (në këtë rast ndërmarrjet publike) se do të veprohej në mënyrën e duhur ndaj denoncimit, një shpjegim tjetër është se denoncuesit e mundshëm nuk janë të njohur me këtë mekanizëm, ndërsa shpjegimi i tretë do të ishte se denoncuesit potencial kanë frikë të raportojnë, për shkak të pasojave të mundshme në të ardhmen. Nga të dhënat plotësuese mundët, si vijon:

- të gjitha ndërmarrjet që morën denoncime i kanë informuar denoncuesit për rezultatin (tabela 17);
- ndërmarrjet nuk i kanë përcjellë denoncimet më tutje deri te institucionet e tjera (përcjellja e brendshme në kuadër të ndërmarrjes nuk ka karakter të përcjelljes së jashtme) (tabela 18);
- vetëm për një ndërmarrje është bërë denoncim i jashtëm i mbrojtur (tabela 20);
- nuk është kryer mbikëqyrje në asnjë ndërmarrje (tabela 21);
- asnjë ndërmarrje nuk i është shqiptuar gjobë (tabela 22) dhe
- vetëm 6 ndërmarrje kanë organizuar trajnime për të punësuarit e tyre në mënyrë që të mësojnë se si të jenë denoncues (përgjigjja se punësuarit janë të trajnuar përmes shpalljes së njoftimit në tabelën e shpalljeve nuk do ta konsiderojmë si trajnim) (tabela 23).

¹³Në listën e Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit, Maqedonia e Veriut renditet e 85-ta në vitin 2022 që paraqet një përmirësim të dukshëm krahasuar me vitin 2020 kur u rendit në vendin e 111-të. Të dhënat janë të disponueshme në lidhjen e mëposhtme <https://www.transparency.org/en/cpi/2022/index/mkd>. Dobësi serioze në parandalimin e korrupsionit vërehen edhe në Raportin për progresin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Evropian për vitin 2022. Raporti është në dispozicion në lidhjen: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/north-macedonia-report-2022_en.

MARRËDHËNIA NDËRMJET NDËRMARRJES PUBLIKE DHE THEMELUESIT DHE MEKANIZMAT E KONTROLLIT

Në pjesën e dytë të këtij studimi, bëhet analiza e vendosjes, organizimit dhe transparencës së ndërmarrjeve publike, si dhe marrëdhëniet ndërmjet ndërmarrjes publike dhe themeluesit, pavarësisht nëse bëhet fjalë për ndërmarrje publike të themeluar nga njësit e vetëqeverisjes lokale apo ndërmarrje publike e themeluar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në këtë kuptim, janë përgatitur indikatorë që duhet të mundësojnë matjen e shkallës së zbatimit të Ligjit për ndërmarrjet publike, Ligjin për qasje të lirë te informatat me karakter publik dhe Ligjit për vetëqeverisje lokale. Kjo pjesë e studimit përbëhet nga njësitë, si vijon:

1. Vendosja, përzgjedhja dhe kompetencat e organeve të ndërmarrjeve publike
2. Transparenca, llogaridhënia, kontrolli dhe praktikatat kundër korrupsionit të ndërmarrjeve publike
3. Marrëdhënia e ndërsjellë ndërmjet ndërmarrjes publike dhe themeluesit.

VENDOSJA, PËRZGJEDHJA DHE KOMPETENCAT E ORGANEVE TË NDËRMARRJEVE PUBLIKE

Në pajtim me nenin 16 të Ligjit për ndërmarrjet publike, organet e ndërmarrjes publike janë: këshilli drejtues, këshilli mbikëqyrës për kontrollin e punës materiale -financiare dhe drejtori.

Këshilli i drejtues i ndërmarrjes publike i themeluar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, qyteti i Shkupit, komuna në të cilën jetojnë më shumë se 50.000 banorë, si dhe këshilli drejtues i ndërmarrjes publike ndër komunale përbëhet prej shtatë anëtarësh. Këshilli drejtues i ndërmarrjes publike i themeluar nga komuna në të cilën jetojnë deri në 50.000 banorë përbëhet nga pesë anëtarë.

Kushtet që duhet të plotësojë anëtari i këshillit drejtues të ndërmarrjes publike, të cilat janë të përcaktuara në nenin 17 [2] të Ligjit për ndërmarrjet publike janë, si vijon:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- Të ketë përvetësuar të paktën 240 kreditë sipas EKTS-së ose të ketë përfunduar arsimin e shkallës VII/1 dhe
- në momentin e emërimit me aktgjykim të plotfuqishëm nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion kundërvajtës ndalesë për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë dhe detyrës.

Në mënyrë plotësuese, dhe me qëllim të forcimit të kapaciteteve të ndërmarrjes publike, në nenin 17 janë paraparë rregulla të mbi ndërtuara në atë drejtim, edhe atë:

- dy anëtarë të këshillit drejtues duhet të kenë së paku 5 vite përvojë nga fusha e veprimtarisë së ndërmarrjes publike, në përputhje me Klasifikimin nacional të veprimtarive të publikuara nga ana e Entit Shtetëror të Statistikës,
- së paku një anëtar i këshillit drejtues duhet të ketë së paku tre vite përvojë pune nga fusha e punës financiare,
- së paku një anëtar i këshillit drejtues duhet të ketë së paku tre vite përvojë pune nga fusha e punëve juridike dhe
- së paku një anëtar i këshillit drejtues duhet të ketë tre vite përvojë pune nga fusha e shkencave teknike.

Dispozita e cituar lejon që këshilli drejtues i ndërmarrjes publike në përbërjen e tij të përfshijë anëtarë që kanë kompetenca të ndryshme. Përveç kësaj, kjo dispozitë parasheh edhe një minimum të përshtatshëm të përvojës së punës në këtë fushë.

Neni 17 i Ligjit për ndërmarrjet publike parasheh gjithashtu se kohëzgjatja e mandatit të anëtarëve të këshillit drejtues të ndërmarrjes publike është katër vjet, me të drejtë edhe një mandat të njëpasnjëshëm.

Me qëllim të zgjerimit të procesit dhe sigurimit të përfshirjes më të madhe, në nenin 17-a të Ligjit për ndërmarrjet publike, parashihet, që për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit drejtues të ndërmarrjes publike të themeluar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, , tre muaj para përfundimit të mandatit të anëtarëve ekzistues, me propozim të Sekretarit të Përgjithshëm, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut shpall thirrje publike për paraqitjen e personave të interesuar, në ueb faqen e saj të internetit dhe në ueb faqen e ndërmarrjes publike për të cilën është shpallur thirrja publike, ndërsa për zgjedhjen e anëtarëve në këshillin drejtues të ndërmarrjes publike të themeluar nga komuna dhe qyteti i Shkupit, tre muaj para skadimit të mandatit të anëtarëve ekzistues, me propozim të kryetarit të komunës, respektivisht kryetarit të Qytetit të Shkupit, Këshilli Komunal, respektivisht Këshilli i Qytetit të Shkupit shpall thirrje publike për paraqitjen e personave të interesuar, në ueb-faqen e tij dhe në ueb-faqen e ndërmarrjes publike, për të cilën është shpallur thirrja publike.

Neni 17-b i Ligjit për ndërmarrjet publike rregullon procedurën për seleksionimin e anëtarëve të këshillit drejtues, e cila përbëhet nga dy faza, përkatësisht përzgjedhja administrative dhe intervista. Seleksionimi administrativ përmban kontrollin e të dhënave të shënuara në aplikimin me kushtet e përcaktuara në thirrjen publike, kontrollin e dëshmimeve të dorëzuara dhe vlerësimin e tyre me pikë. Numri i përgjithshëm i pikëve për çdo kandidat të paraqitur përcaktohet në bazë të pikëve nga arsimi i përvetësuar dhe përvoja e punës në profesion. Kandidatët që kalojnë seleksionimin administrativ marrin pjesë në pjesën e dytë të përzgjedhjes, pra në intervistë. Në intervistë, përmes pyetjeve të situatës, kontrollohen kompetencat e përgjithshme të punës për anëtar të këshillit drejtues, dhe përmes pyetjeve profesionale ose detyrave praktike, kontrollohen kompetencat e veçanta të punës dhe bëhet vlerësimi i tyre me pikë.

Kompetencat e këshillit drejtues janë të rregulluara në nenin 19 të Ligjit për ndërmarrjet publike.

Në bazë të nenit 19 të Ligjit për ndërmarrjet publike, këshilli drejtues ka këto kompetenca:

- miraton statusin e ndërmarrjes publike;
- e miraton programin për punë dhe zhvillim të ndërmarrjes publike;
- e rregullon politikën e biznesit;
- i miraton raportin tremujor i cili përmban indikatorë për punën financiare, llogarinë vjetore dhe raportin për punën e ndërmarrjes publike;
- vendos për shfrytëzimin e mjeteve të realizuara me punën e ndërmarrjes publike dhe mbulimin e humbjeve;

- i sjell vendimet për investime;
- i përcakton çmimet e prodhimeve dhe shërbimeve;
- vendos për organizimin e brendshëm të ndërmarrjes publike;
- e miraton aktin për përcaktimin e lartësisë së vlerës së pikës për përlogaritje të rrogave të të punësuarve në ndërmarrjen publike;
- kryen punë tjera të përcaktuara me aktin për themelimin dhe statusin e ndërmarrjes publike dhe
- e zgjedh dhe shkarkon drejtorin dhe zëvendësdrejtorin e ndërmarrjes publike, të themeluar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë në bazë të konkursit publik.

E drejta e kompensimit mujor si dhe shuma maksimale e kompensimit për anëtarët e këshillit drejtues është e rregulluar në nenin 19 [2] të Ligjit për ndërmarrjet publike, sipas të cilit kryetari dhe anëtarët e këshillit drejtues publikut të ndërmarrjes publike kanë të drejtë në kompensim mujor për punën e tyre, në bazë të pjesëmarrjes në mbledhjet e këshillit drejtues të ndërmarrjes publike. Kompensimi i përgjithshëm mujor i kryetarit dhe anëtarëve të këshillit drejtues individualisht, nuk duhet të kalojë vlerën e gjysmës së pagës mesatare neto të të punësuarve në ndërmarrjen publike të paguar në vitin paraprak.

Roli dhe pozita e drejtorit të ndërmarrjes publike rregullohet me nenin 23 [5] të Ligjit për ndërmarrjet publike, sipas të cilit, drejtori i ndërmarrjes publike siguron zbatimin e vendimeve dhe konkluzioneve të këshillit drejtues, merr pjesë në zbatimin e bazave të programit të punës dhe zhvillimit, merr pjesë në përcaktimin e kriterëve për shfrytëzimin dhe disponimin e mjeteve dhe përdorimin e mjeteve të realizuara nga funksionimi i ndërmarrjes publike, kryen harmonizimin e veprimtarisë afariste të ndërmarrjes publike dhe kryen punë të tjera ekzekutive në lidhje me punën dhe funksionimin e ndërmarrjes publike të përcaktuara me statut.

Kushtet në të cilat një person mund të zgjidhet drejtor i një shoqërie publike janë të përcaktuara në nenin 23 [4] të Ligjit për ndërmarrjet publike, sipas të cilit personi duhet:

- është shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- ka marrë së paku 240 kredi sipas SETK ose ka mbaruar shkallën VII/1 të arsimit,
- në momentin e emërimit me aktgjykim gjyqësor të plotfuqishëm nuk i është shqiptuar dënim ndalim i kryerjes së profesionit, veprimtarisë ose detyrës,
- ka së paku pesë vjet përvojë pune,
- posedon një nga certifikatat apo dëshmitë e njohura ndërkombëtarisht për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet si vijon: TOEFEL IBT (TOEFL iBT) - së

paku 74 pikë, IELTS (IELTS) - së paku 6 pikë, ILEC (ILEC) [Cambridge English: Legal] - së paku nivelin B2 (B2), FCE (FCE) [Cambridge English: First] - të kaluar, BULATS (BULATS) - së paku 60 pikë ose APTIS [APTIS] – së paku nivelin B2 (B2).

Drejtori është i obliguar që çdo gjashtë muaj të dorëzojë raport për punën e ndërmarrjes publike te këshilli drejtues, përkatësisht kryetari i komunës, përkatësisht qytetit të Shkupit, në pajtim me obligimin e tij nga neni 23-a të Ligjit për ndërmarrjet publike. Në raport drejtori është i detyruar të japë të dhëna për llojin dhe vëllimin e punëve të kryera gjatë kryerjes së veprimtarisë së ndërmarrjes publike, si dhe të dhëna për punën financiare. Nëse nga raporti i punës konstatohen mangësi dhe/ose humbje në operacionet financiare, drejtori është i detyruar t'i mënjanoj ato në gjashtë muajt e ardhshëm. Drejtori është i detyruar t'i publikojë raportin tremujor i cili përmban indikatorë për punën financiare, llogarinë vjetore dhe raportin për punën e ndërmarrjes publike në ueb faqen e ndërmarrjes publike.

Tabela 24:

Vallë për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit drejtues shpallni thirrje publike në përputhje me nenin 17-a të Ligjit për ndërmarrjet publike? Nëse po, ku publikohet thirrja publike? Ju lutemi na jepni një lidhje për thirrjen e fundit publike?	1 ndërmarrje publike nuk ka dorëzuar përgjigje
	31 kompani publike ju janë drejtuar themeluesit si posedues të informacionit
	12 ndërmarrje publike nuk kanë vepruar (para zbatimit të ligjit)

Tabela 25:

Sa anëtarë ka këshilli drejtues i ndërmarrjes? ¹⁴	1 ndërmarrje publike nuk ka dorëzuar përgjigje
	2 ndërmarrje publike nuk kanë informacion se sa anëtarë ka këshilli drejtues i tyre ¹⁵
	3 ndërmarrje publike kanë nga 4 anëtar në këshillin drejtues
	17 ndërmarrje publike kanë nga 5 anëtar në këshillin drejtues
	14 ndërmarrje publike kanë 7 anëtarë në këshillin drejtues
	3 ndërmarrje publike kanë 9 anëtarë në këshillin drejtues
	1 ndërmarrje publike ka 11 anëtarë në këshillin drejtues
	2 ndërmarrje publike kanë 12 anëtarë në këshillin drejtues
	1 ndërmarrje publike ka 13 anëtarë në këshillin drejtues ¹⁶

Tabela 26:

Sa persona janë paraqitur në thirrjen e fundit publike për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit drejtues? Ju lutemi na dorëzoni thirrjen e fundit publike për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit drejtues?	1 kompani publike nuk ka dorëzuar përgjigje
	43 kompani publike iu drejtuan themeluesit si posedues të informacionit

¹⁴Numri i anëtarëve është përcaktuar në pajtim me përbërjen e plotë të anëtarëve. Një pjesë e ndërmarrjeve deklaruan se për momentin janë duke punuar me një numër më të vogël të anëtarëve të këshillit drejtues se sa pritej dhe janë në proces procedurat e përzgjedhjes.

¹⁵NPK "Vrapçishtë"-Vrapçishtë dhe N.P.K Ujësjellës dhe Kanalizim – Prilep.

¹⁶N.P "Parqe dhe Gjelbërim"-Shkup ka më së shumti anëtarë në këshillin drejtues.

KONKLUZION

Analiza e segmentit të përzgjedhjes së organeve të ndërmarrjeve publike dhe transparencës e procedurës për përzgjedhjen e anëtarëve në organet e ndërmarrjeve, tregoi një nivel të lartë të mbylljes së ndërmarrjeve lidhur me sigurimin e të dhënave. Pra, pas dy të dhënave të kërkuara, përkatësisht: (a) qasje në thirrjen publike për zgjedhjen e anëtarëve të këshillit drejtues, 31 ndërmarrje publike iu drejtuan themeluesit si posedues të informacionit (tabela 24) dhe (b) numri i personave të paraqitur për thirrje, 43 ndërmarrje publike iu drejtuan themeluesit si posedues të informacionit (tabela 26). Kjo veprim i ndërmarrjeve publike e vë në pikëpyetje nenin 18 të Ligjit për qasje të lirë të informatat me karakter publik, sipas të cilit, "nëse poseduesi i informacionit që e ka pranuar kërkesën nuk disponon me informacionin e kërkuar menjëherë, e më së voni brenda tri ditëve nga dita e pranimit së kërkesës, është i detyruar t'ia dërgoj kërkesën poseduesit të informacionit, i cili sipas përmbajtjes së kërkesës është pronar i informacionit dhe për këtë ta informojë kërkuesin." Është e qartë se ndërmarrjet publike të përfshira në këtë hulumtim nuk kanë vepruar sipas nenit 18 të Ligjit për qasje të lirë të informatat me karakter publik. Ky është një problem shtesë, nëse personi i referuar si mbajtësi i informacionit është në të vërtetë themeluesi i tyre dhe jo një palë e tretë e palidhur. Gjithashtu konfuz është fakti se dy ndërmarrje publike raportuan se nuk kishin informacion se sa anëtarë ka këshilli drejtues (tabela 25).

TRANSPARENCA, LLOGARIDHËNIA, KONTROLLI DHE PRAKTIKAT KUNDËR KORRUPSIONIT TË NDËRMARRJEVE PUBLIKE

Ligji për ndërmarrjet publike parasheh një sërë dispozitash për transparencën dhe llogaridhënien e ndërmarrjes. Në këtë drejtim, në pajtim me nenin 7-a të Ligjit, ndërmarrja publike është e detyruar të publikojë llogaritë vjetore dhe raportet financiare në ueb faqen e saj të internetit brenda 15 ditëve nga dita e dorëzimit të llogarisë vjetore në Regjistrin Qendror, përkatësisht, ndërmarrja publike e cila nuk ka ueb faqe të internetit, llogaritë vjetore dhe raportet financiare, është e detyruar t'i publikojë në ueb faqen e themeluesit.

Po ashtu në nenin 5 [4] të Ligjit për ndërmarrjet publike, është paraparë detyrimi për ndërmarrjen publike, pas miratimit të raportit tremujor që përmban tregues për punën financiare nga ana e këshillit drejtues të ndërmarrjes publike, të njëjtën ta publikojë në ueb faqen e internetit jo më vonë se 35 ditë pas përfundimit të tremujorit. Ndërmarrja publike që nuk ka ueb faqe është e detyruar që raportin ta publikojë në faqen e themeluesit.

Veçanërisht rol të rëndësishëm kontrolli është paraparë në nenin 11 të Ligjit për ndërmarrjet publike, sipas të cilit themeluesi i ndërmarrjes publike jep pëlqim për një numër të madh aktesh të ndërmarrjes publike.

Me qëllim ushtrimin e kontrollit mbi punën e ndërmarrjes publike është i rëndësishëm neni 38 të i Ligjit për ndërmarrjet publike, sipas të cilit, në rast të ndërprerjes së punës, përkatësisht kryerjes së veprimtarisë së ndërmarrjes publike ose nëse ndërmarrja publike nuk i përmbush detyrimet e përcaktuara me ligj dhe që nuk është pasojë e mos përmbushjes së detyrimeve nga themeluesi të përcaktuara me aktin për themelimin, themeluesi mund të marrë masa që sigurojnë kushtet për funksionimin normal të ndërmarrjes publike.

Neni 39 i Ligjit për ndërmarrjet publike si shkelje në punën e ndërmarrjes publike, i konsideron këto situata:

- Nëse me mënyrën e punës së ndërmarrjes publike nuk sigurohet kryerje e përhershme dhe pa pengesë të prodhimtarisë dhe qarkullimi i prodhimeve të caktuara dhe ofrim të shërbimeve, ose realizim të planit për zhvillim, në mënyrë të përcaktuar me ligj, me çka shkaktohet dëm ose mund t'u shkaktohet dëm shfrytëzuesve.
- Nëse me disponim të mjeteve ndryshohet dedikimi themelor i mjeteve, ndryshohen edhe kushtet themelore për punë të ndërmarrjes publike të përcaktuara në përputhje me ligjin, për shkak të realizimit të interesit publik në ndërmarrjen publike, me çka në mënyrë thelbësore rëndohet kryerja e veprimtarisë së saj e përcaktuar me aktin për themelimin dhe
- Në raste tjera të përcaktuara me ligjin.

Në nenin 40 janë të përmbajtura masat që janë në dispozicion të themeluesit dhe kanë për qëllim mënjanimin e çrregullimit të punës së ndërmarrjes, përkatësisht: shkarkimin e këshillit për kontroll, ndryshimin e organizimit të ndërmarrjes publike;

ndalimin e zbatimit të aktit të ndërmarrjes publike i cili është në kundërshtim të ligjit; ndalimin e zbatimit të aktit të ndërmarrjes publike nëse e sjell në diskutim realizimin e funksioneve themelore të ndërmarrjes publike dhe masa të tjera të përcaktuara me ligj të posaçëm me të cilin rregullohen kushtet dhe mënyra e kryerjes së veprimtarisë së caktuar me interes publik.

Në nenin 18 [1] të Ligjit për ndërmarrjet publike, janë të përmbajtura dispozita të veçanta për konflikt të interesit, sipas të cilave, anëtari i këshillit udhëheqës në ndërmarrjen publike nuk mund të ketë interes personal, përmes personit të tretë ose në çfarëdo lloj baze interes në ndërmarrje ose shoqëri tregtare e cila është në marrëdhënie zyrtare me ndërmarrjen publike, të cilët mund të kenë çfarëdo qoftë ndikimi në pavarësinë dhe paanësinë e saj në vendimet në ndërmarrjen publike. Çdo anëtarë i këshillit udhëheqës, përkatësisht drejtori i ndërmarrjes publike, janë të obliguar ta paralajmërojnë themeluesin për ekzistimin e këtij lloji të interesit të një ose më shumë anëtarë të Këshillit udhëheqës.

Gjithashtu, duhet të theksohen kufizimet e veçanta financiare nga neni 21 të Ligjit për ndërmarrjet publike, sipas të cilit, Ndërmarrja publike kryetarit ose anëtarit të këshillit drejtues, kryetarit ose anëtarit të këshillit mbikëqyrës ose drejtorit të ndërmarrjes publike nuk mund t'u japë hua ose garanci të huave, të cilat ata i kanë lidhur me persona të tretë.

Si lloj i veçantë i përgjegjësisë duhet theksuar përgjegjësia nga neni 24 i Ligjit për ndërmarrjet publike, sipas të cilit, drejtori, zëvendësdrejtori, anëtarët e këshillit drejtues dhe anëtarët e këshillit mbikëqyrës, nëse kryejnë, respektivisht nëse marrin vendim për të cilin kanë ditur ose për të cilën duke marrë parasysh rrethanat, doemos duhet të kenë ditur se cenojnë interesat e ndërmarrjes publike, përgjigjen në mënyrë solidare dhe të pakufizuar për dëmin e shkaktuar me vendimin e tillë. Përgjegjësia përcaktohet në pajtim me dispozitat e Ligjit për shoqëritë tregtare që kanë të bëjnë me organet e udhëheqëse.

Ligji për ndërmarrjet publike parasheh edhe kontroll përmes një këshilli mbikëqyrës të ndërmarrjeve publike. Rrjedhimisht, me qëllim të kryerjes së punës së kontrollit, dhe në pajtim me nenin 27 të Ligjit për ndërmarrjet publike, këshilli mbikëqyrës për kontroll mund të kryen hulumtime aty për aty të të gjitha dokumenteve dhe listave të ndërmarrjes publike. Këshilli mbikëqyrës për kontroll mund për shkak të hulumtimeve të dokumenteve dhe listave të ndërmarrjes publike të fton persona të cilët do t'i ndihmojnë në zgjidhjen e mbikëqyrjes.

Tabela 27:

Ju lutemi na jepni lidhje nga ueb faqja ku janë publikuar biografite e anëtarëve të këshillit drejtues në përputhje me nenin 17-d paragrafi (6) të Ligjit për ndërmarrjet publike.	1 ndërmarrje publike nuk ka dorëzuar përgjigje
	6 ndërmarrje publike kanë dorëzuar lidhje
	19 ndërmarrje publike u janë drejtuar një themeluesi
	18 ndërmarrje publike nuk kanë shpallur

Tabela 28:

A ka vepruar themeluesi i ndërmarrjes publike në periudhën 2022, 2021 dhe 2020 në pajtim me nenin 40 të Ligjit për ndërmarrjet publike dhe çfarë mase ka marrë?	1 ndërmarrje publike nuk ka dorëzuar përgjigje
	33 ndërmarrje publike nuk kanë masa
	2 ndërmarrje publike kanë masa
	8 ndërmarrje publike u janë drejtuar themeluesit

Tabela 29:

A publikohen raportet tremujore nga neni 5 paragrafi (3) në përputhje me obligimin nga paragrafi (4) dhe paragrafi (5) të Ligjit për ndërmarrjet publike?	1 ndërmarrje publike nuk ka dorëzuar përgjigje
	27 ndërmarrje publike kanë publikuar
	5 ndërmarrje publike u janë drejtuar themeluesit
	11 ndërmarrje publike nuk kanë ueb faqe interneti

Tabela 30:

A publikon ndërmarrja publike në faqen e saj të internetit të dhënat dhe informacionet e parashikuara në nenin 10 të Ligji për qasje të lirë në informacione me karakter publik? Ju lutemi na jepni lidhje në të cilën janë publikuar informacionet dhe të dhënat e përmendura.	1 ndërmarrje publike nuk ka dorëzuar përgjigje
	24 ndërmarrje publike kanë publikuar në mënyrë të plotë
	3 ndërmarrje publike kanë publikuar pjesërisht
	11 ndërmarrje publike nuk kanë ueb faqe interneti
	5 ndërmarrje publike nuk kanë shpallur

Tabela 31:

A ka përgatitur ndërmarrja publike plane vjetore për vlerësimin e rreziqeve nga korrupsioni (ose akteve të ngjashme)? Nëse keni akte të tilla, ju lutemi na dorëzoni një kopje.	1 ndërmarrje publike nuk ka dorëzuar përgjigje
	23 ndërmarrje publike nuk kanë
	20 ndërmarrje publike kanë

Tabela 32:

A ka përgatitur ndërmarrja publike akte të brendshme për parandalimin e konfliktit të interesit? Nëse keni akte të tilla, ju lutemi na dorëzoni një kopje.	1 ndërmarrje publike nuk ka dorëzuar përgjigje
	36 ndërmarrje publike nuk kanë akte të konfliktit të interesit
	2 ndërmarrje publike kanë deklaruar konfliktin e interesit
	5 ndërmarrje publike kanë akte të brendshme

Tabela 33:

A ka përgatitur ndërmarrja publike për të punësuarit në ndërmarrjen publike akte të brendshme për marrjen e dhuratave nga persona të tretë? Nëse keni akte të tilla, ju lutemi na dorëzoni kopje.	1 ndërmarrje publike nuk ka dorëzuar përgjigje
	37 ndërmarrje publike nuk kanë akte të brendshme
	1 ndërmarrje publike thirret në kodin e përgjithshëm
	1 ndërmarrje publike thirret në kodin e nëpunësve administrativë
	4 ndërmarrje publike kanë akte të brendshme

KONKLUZION

Konkluzioni i përgjithshëm është se mungon transparenca në ndërmarrjet publike dhe sa i përket qasjes në informata me karakter publik lidhur me organet e ndërmarrjes si dhe raportet e punës. Njëherit, vetëm 6 ndërmarrje publike (tabela 27) i publikojnë biografitë e anëtarëve të këshillit drejtues në ueb faqen e tyre të internetit, dhe 19 ndërmarrje publike i drejtohen themeluesve. Por nga ana tjetër, siç shihet në tabelën 41, themeluesit (komunat dhe qeveria) nuk i publikojnë biografitë e tyre, por i adresohen ndërmarrjes publike. Në atë mënyrë krijohet një hapësirë vakum dhe moszbatim faktik të dispozitës së nenit 17-d (5). Njashtu, ky obligim (si dhe obligimet e ngjashme që kanë të bëjnë me publikimin në faqen e internetit) nuk janë të zbatueshme, duke pasur parasysh se një numër i madh i ndërmarrjeve publike nuk kanë ueb faqe të tyre të internetit. Më tutje, vetëm 27 ndërmarrje publike i kanë publikuar raportet e tyre tremujore (tabela 29) dhe vetëm 24 ndërmarrje publike i kanë publikuar në tërësi të dhënat që kërkohen në bazë të nenit 10 të Ligjit për qasje të lirë te informatat me karakter publik (tabela 30).

Më tutje, të gjitha praktikatat kundër korrupsionit lidhur me përgatitjen e dokumenteve të brendshme kundër korrupsionit në nivel të ndërmarrjeve publike janë në nivel të ulët dhe të mesëm. Lidhur me këtë:

- vetëm 23 ndërmarrje publike kanë përgatitur plane vjetore për vlerësimin e rreziqeve të korrupsionit (tabela 31);
- vetëm 5 ndërmarrje publike kanë akte të brendshme për parandalimin e konfliktit të interesit (tabela 32) dhe
- vetëm 4 ndërmarrje publike kanë akte të brendshme për pranimin e dhuratave (tabela 33).

MARRËDHËNIET E NDËRSJELLA TË NDËRMARRJES PUBLIKE DHE THEMELUESIT

a) Marrëdhëniet ndërmjet ndërmarrjes publike dhe themeluesit të saj

Në bazë të nenit 1 të Ligjit për ndërmarrjet publike, ndërmarrjet publike mund të themelohen me qëllim të kryerjes së veprimtarive me interes publik, ndërsa si themelues të ndërmarrjes publike janë Republika e Maqedonisë së Veriut, komunat dhe qyteti i Shkupit. Ndërmarrjet publike në emër të Republikës së Maqedonisë së Veriut themelohen nga Qeveria, në emër të komunës - Këshillit të komunës dhe në emër të Qytetit të Shkupit - Këshillit të Qytetit të Shkupit.

Në nenin 5 të Ligjit për ndërmarrjet publike parashihet që mjetet për punën dhe zhvillimin e ndërmarrjes publike të sigurohen nga të ardhurat të cilat i realizon me punën e saj, nga mjetet kreditore dhe nga burime tjera në përputhje me ligj.

Mjetet nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë dhe mjetet nga buxheti i komunës, përkatësisht qyteti i Shkupit të ndërmarrjes publike sigurohen në përputhje me ligjin me të cilin rregullohen kushtet dhe mënyra e kryerjes së veprimtarive ekonomike të veçanta me interes publik.

Në bazë të nenit 9 të Ligjit për ndërmarrjet publike, Qeveria, Këshilli i Komunave dhe Këshilli i Qytetit të Shkupit sjellin akt për themelimin të ndërmarrjes publike.

Pjesëmarrja e themeluesit në punën e ndërmarrjes publike shihet edhe nga dispozita e nenit 22 të Ligjit për ndërmarrjet publike, sipas të cilit Qeveria e Republikës së Maqedonisë, respektivisht komuna ose Qyteti i Shkupit, me propozim të ministrit kompetent për çështjet e veprimtarisë adekuate, mund t'i japë këshillit drejtues të ndërmarrjes publike orientime me karakter të përgjithshëm në drejtim të kryerjes së disa punëve nga fushëveprimi i këshillit drejtues të përcaktuara me ligj, e të cilat Qeveria, përkatësisht Qyteti i Shkupit konsideron se janë me interes për Republikën e Maqedonisë, përkatësisht për komunën ose për Qytetin e Shkupit.

Tabela 34:

A mban ndërmarrja publike mbledhje të rregullta me përfaqësues të themeluesit në periudhën 2022, 2021 dhe 2020? Nëse mbani mbledhje, a janë ato mbledhje zyrtare ku mbahen procesverbale? Sa shpesh zhvillohen këto mbledhje?	1 ndërmarrje publike nuk ka dorëzuar përgjigje
	4 ndërmarrje publike mbajnë mbledhje të rregullta dhe mbajnë procesverbal
	39 ndërmarrje publike mbajnë mbledhje të rregullta, por nuk mbajnë procesverbal

Tabela 35:

Sa pyetje keni marrë nga këshilltarët e këshillit të njërive të vetëqeverisjes lokale, themelues i ndërmarrjes publike në periudhën 2022, 2021 dhe 2020? Për sa nga pyetjet keni përgatitur dhe dorëzuar një përgjigje? Ju lutemi na jepni një kopje të përgjigjeve.	1 ndërmarrje publike nuk ka dorëzuar përgjigje
	16 ndërmarrje publike nuk kanë pyetje nga këshilltarët
	14 ndërmarrje publike janë themeluar nga Qeveria
	13 ndërmarrje publike kanë marrë pyetje nga këshilltarët

KONKLUZION

Në përgjithësi, nga këndvështrimi i ndërmarrjeve publike, rreth 39 ndërmarrje publike organizojnë bashkëpunim me themeluesin përmes takimeve të rregullta, por nuk mbajnë procesverbal (tabela 34) dhe vetëm 13 ndërmarrje publike kanë marrë pyetje këshilluese nga anëtarët e këshillit nga njësia e vetëqeverisjes lokale që i ka themeluar (tabela 35).

b) Marrëdhënia themelues me ndërmarrje publike

Një segment i veçantë i hulumtimit është qëndrimi i themeluesit të ndërmarrjes publike ndaj kompanisë. Njëherit, del nga fakti se themeluesi i ndërmarrjes është bartës i kontrollit mbi funksionimin e ndërmarrjes.

Ligji për vetëqeverisjen lokale në nenin 8 [1] rregullon një çështje shumë të rëndësishme për transparencën e komunave, sipas së cilës, organet e komunës, komisionet e këshillit dhe shërbimet publike të themeluara nga komuna janë të obliguara pa kompensim t'i informojnë qytetarët për punën e tyre, si dhe për planet dhe programet që janë të rëndësishme për zhvillimin e komunës, në mënyrën e përcaktuar me statut. Komuna është e obliguar t'i mundësojë qytetarëve qasje në informatat bazë për shërbimet që ofron, në mënyrën dhe kushtet e rregulluara me statut.

Bazën që e vendos Ligji për vetëqeverisje lokale, me të cilin mundëson dhe themelimin e subjekteve juridike siç janë ndërmarrjet publike, është neni 24, sipas të cilit, komunat mund të themelojnë shërbime publike, në pajtim me ligjin.

Duke pasur parasysh se Këshilli Komunal shfaqet si themelues i një ndërmarrje publike komunale në emër të komunës, duhet të shpjegohet gjithashtu roli dhe pozita e Këshillit

komunal. Njëherit, në pajtim me nenin 32 [1] të Ligjit për vetëqeverisje lokale, këshilli është organ përfaqësues i qytetarëve që vendos në kuadër të kompetencave të komunës. Në mënyrë plotësuese, neni 33 [1] i Ligjit për vetëqeverisje lokale parasheh se këshilli i përbëjnë përfaqësues të qytetarëve të zgjedhur në zgjedhje të përgjithshme, të drejtpërdrejta dhe të lira me votim të fshehtë.

Në Nenin 36 të Ligjit për vetëqeverisje lokale janë të rregulluara kompetencat e Këshillit, nga të cilat më të rëndësishme në aspektin e këtij hulumtimi janë kompetencat e Këshillit për themelimin e shërbimeve publike, emërimin e anëtarëve të këshillave drejtuese të shërbimeve publike të themeluara nga këshilli, miratimi i programeve për punë dhe të planeve financiare për financimin e shërbimeve publike, të cilat i ka themeluar komuna, si dhe miratimi i raporteve për punë dhe llogaritë vjetore të shërbimeve publike, të cilat i ka themeluar komuna.

Gjithashtu, sa i përket transparencës së Këshillit duhet theksuar neni 42 [2] i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, sipas të cilit, sipas rregullit, seancat e Këshillit janë publike.

Me qëllim të parandalimit të konfliktit të interesave, neni 44 [5] të Ligjit për vetëqeverisje lokale parashihet, se anëtari i këshillit i punësuar në shërbimet publike të cilat janë themeluar nga komuna nuk mund të marrë pjesë në vendimmarrje për çështje që kanë të bëjnë me shërbimin publik në të cilin është i punësuar.

Paralelisht me kompetencat e këshillit, dhe sa i përket punës së shërbimeve publike, duhet të theksohen edhe kompetencat e kryetarit të komunës të përcaktuara në nenin 50 të Ligjit për vetëqeverisje lokale. Në këtë drejtim, kryetari i komunës zgjedh drejtorët e shërbimeve publike të cilat i ka krijuar komuna, në bazë të konkursit publik. Dispozita duhet parë në linjë me nenin 23 të Ligjit për ndërmarrjet publike.

Ligji për vetëqeverisjen lokale parasheh dispozita për konflikt të interesit dhe në punën e kryetarit të komunës. Në bazë të nenit 53 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale, kryetari i komunës nuk mund të emërohet si anëtar i organeve mbikëqyrëse, administrative dhe kontrolluese të shoqërive tregtare dhe shërbimeve publike.

Një mjet i veçantë i kontrollit të themeluesit është mundësia e shkarkimit të anëtarëve të këshillit drejtues në pajtim me nenin 17-f të Ligjit për ndërmarrjet publike. Gjegjësisht, themeluesi mund t'i shkarkojë të gjithë anëtarët e këshillit drejtues të ndërmarrjeve publike para përfundimit të mandatit nëse nuk e miraton llogarinë vjetore dhe raportin e funksionimit të ndërmarrjes publike, në pajtim me nenin 11 pika 7 të Ligji për ndërmarrjet publike. Themeluesi i ndërmarrjes publike mund të shkarkojë kryetarin ose anëtarin e këshillit drejtues të shoqërisë publike në këto raste: me kërkesën e tij, nëse mungon pa arsye në mbledhjet e këshillit drejtues dy ose tre herë radhazi herë apo tre herë gjatë një

viti kalendarik, nëse vërtetohet se ka dhënë të dhëna të rreme në procedurën e emërimit të tij dhe nëse me aktgjykim gjyqësor të formës së prerë gjatë ushtrimit të detyrës është dënuar me gjobë ose sanksion kundërvajtës, ndalim në ushtrimin e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Tabela 36:

Ndërmarrjet publike themelues i të cilave jeni ju, a dorëzojnë raporte tremujore në pajtim me nenin 5 të Ligjit për ndërmarrje publike brenda 20 ditëve pas përfundimit të tremujorit? Ju lutemi na dorëzoni numrin arkivor të pranimit të materialit.	2 themelues nuk dorëzuan informacione
	11 themelues janë deklaruar se ndërmarrjet i dorëzojnë
	6 themelues janë deklaruar se kompanitë nuk i dorëzojnë

Tabela 37:

A publikohen raportet tremujore, si dhe llogaritë vjetore dhe raportet financiare në faqen tuaj të internetit në përputhje me nenin 5 të Ligjit për ndërmarrjet publike? Ju lutemi na jepni lidhje deri në publikimin.	2 themelues nuk dorëzuan informacione
	6 themelues publikojnë
	11 themelues nuk publikojnë

Tabela 38:

A keni dhënë dhe sa pëlqime keni dhënë në periudhën 2022, 2021 dhe 2020 bazuar në nenin 11 të Ligjit për ndërmarrjet publike?	2 themelues nuk dorëzuan informacione
	15 themelues kanë dhënë pëlqimin e tyre
	2 themelues nuk kanë dhënë pëlqimin e tyre

Tabela 39:

A keni shkarkuar anëtarë të këshillit drejtues të ndërmarrjes publike në periudhën 2022, 2021 dhe 2020 dhe mbi çfarë baze janë shkarkuar? Ju lutemi të na jepni një kopje të aktit me të cilin është kryer shkarkimi.	2 themelues nuk dorëzuan informacione
	14 themelues kanë shkarkuar anëtar të këshillit drejtues
	3 themelues nuk kanë shkarkuar anëtar të këshillit drejtues

Tabela 40:

Në periudhën 2022, 2021 dhe 2020, a keni vepruar në përputhje me nenin 17-f të Ligjit për ndërmarrjet publike dhe a keni shkarkuar anëtarë të Këshillit drejtues për shkak të mosmiratimit të llogarisë vjetore dhe raportit të funksionimit të ndërmarrjes publike?	2 themelues nuk dorëzuan informacione
	2 themelues kanë shkarkuar anëtarë të këshillit drejtues
	15 themelues nuk i kanë shkarkuar anëtarët e këshillit drejtues

Tabela 41:

Ju lutemi na jepni një lidhje me publikimin e biografive të anëtarëve të këshillit drejtues në përputhje me nenin 17d të Ligjit për ndërmarrjet publike	2 themelues nuk kanë dorëzuar informacione
	17 themelues nuk kanë dorëzuar lidhje

Tabela 42:

A keni akte dhe dokumente të veçanta të brendshme për paraqitjen dhe vlerësimin e konfliktit të interesit në pajtim me nenin 18 të Ligjit për ndërmarrjet publike? Ju lutemi nëse keni, na dorëzoni një kopje?	2 themelues nuk dorëzuan informacione
	1 themelues ka akte në nivel themeluesi, jo në nivel ndërmarrjeje
	16 themelues nuk kanë akte të veçanta që kanë të bëjnë me ndërmarrjet publike të të cilave janë themelues

Tabela 43:

A keni raportuar dhe sa raste të konfliktit të interesit në pajtim me nenin 18 të Ligjit për ndërmarrjet publike në periudhën 2022, 2021 dhe 2020?	2 themelues nuk dorëzuan informacione
	1 themelues kryen vettingun
	16 themelues nuk kanë raportuar rast të konfliktit të interesit

Tabela 44:

A po përgatitni plane vjetore për vlerësimin e rreziqeve të korrupsionit në të cilat keni përfshirë edhe dispozitat përkatëse për ndërmarrjen publike themelues të së cilës jeni, në periudhën 2022, 2021 dhe 2020? Nëse posedoni akte të tilla, ju lutemi na dorëzoni një kopje.	2 themelues nuk dorëzuan informacione
	2 themelues kanë akte të përgjithshme në nivel themeluesi
	15 themelues nuk kanë akte që kanë të bëjnë me një ndërmarrje publike

Tabela 45:

Si e vlerësoni bashkëpunimin me këshillin drejtues të ndërmarrjes publike për periudhën 2022, 2021 dhe 2020?	2 themelues nuk dorëzuan informacione
	6 themelues e vlerësuan bashkëpunimin korrekt dhe pozitiv
	10 themelues e vlerësuan bashkëpunimin si të shkëlqyer
	1 themelues deklaroi se nuk dispononte informacionin e kërkuar

Tabela 46:

Si e vlerësoni bashkëpunimin me drejtorin e ndërmarrjes publike për periudhën 2022, 2021 dhe 2020?	2 themelues nuk dorëzuan informacione
	7 themelues e vlerësuan bashkëpunimin korrekt dhe pozitiv
	8 themelues e vlerësuan bashkëpunimin si të shkëlqyer
	1 themelues deklaroi se nuk dispononte informacionin e kërkuar
	1 themelues e vlerësoi bashkëpunimin negativisht

Tabela 47:

A mbani takime të rregullta me drejtorin dhe anëtarët e këshillit drejtues të ndërmarrjes publike në periudhën 2022, 2021 dhe 2020? Nëse mbani mbledhje, a janë ato takime zyrtare ku mbahen procesverbale? Sa shpesh zhvillohen këto takime?	2 themelues nuk dorëzuan informacione
	15 themelues kanë takime të rregullta formale dhe joformale, asnjë nuk ka dorëzuar procesverbal
	1 themelues deklaroi se nuk ka komunikim të rregullt
	1 themelues deklaroi se nuk dispononte informacionin e kërkuar

KONKLUZION

Segmenti i fundit i këtij studimi kishte për qëllim vlerësimin e bashkëpunimit ndërmjet ndërmarrjeve publike dhe themeluesve, por në aspekt të themeluesve. Në këtë drejtim, 11 themelues janë deklaruar se ndërmarrjet dorëzojnë raporte tremujore [tabela 36], ndërsa 6 themelues i publikojnë këto raporte në ueb-faqet e tyre të internetit [tabela 37]. Pesëmbëdhjetë themelues përmes mekanizmit të kontrollit të nenit 11 të Ligjit për ndërmarrjet publike kanë dhënë pëlqimin për akte [tabela 38]. Sa i përket kontrollit përmes shkarkimit dhe zgjedhjes së anëtarëve të këshillit drejtues, 14 themelues kanë shkarkuar në përgjithësi anëtarë të këshillit drejtues [tabela 39], dhe vetëm 2 themelues kanë shkarkuar anëtarë të këshillit drejtues sipas nenit 17-f të Ligji për ndërmarrjet publike [tabela 40]. Asnjë nga themeluesit që kanë dorëzuar të dhënat nuk ka dorëzuar link të biografive të publikuara të anëtarëve të këshillit drejtues në përputhje me nenin 17d të Ligjit për ndërmarrjet publike [tabela 41].

Në segmentin e praktikave dhe politikave kundër korrupsionit të themeluesve të ndërmarrjeve publike gjithashtu vërehet mungesa e akteve përkatëse. Lidhur me këtë:

16 themelues nuk kanë akte të veçanta për konflikt interesi që kanë të bëjnë me ndërmarrjet publike [tabela 42].

16 ndërmarrje publike nuk kanë paraqitur të konfliktit të interesit [tabela 43] dhe

15 ndërmarrje publike nuk kanë akte për vlerësimin e rreziqeve të korrupsionit në ndërmarrjet publike të themeluara prej tyre [tabela 44].

Nga të dhënat e mbledhura, si dhe sipas vlerësimit të bashkëpunimit me ndërmarrjet publike të themeluara prej tyre, shumica e themeluesve vlerësojnë pozitivisht bashkëpunimin me këshillin drejtues dhe drejtorin e ndërmarrjes [tabelat 45 dhe 46] dhe mbajnë takime të rregullta por nuk kanë dorëzuar procesverbale [tabela 47]. Ajo që është interesante është se një themelues deklaroi se nuk e kishte këtë lloj informacioni, pas tre treguesve të njëpasnjëshëm. Është e paqartë se si ka mundësi që ai të mos ketë informacion për bashkëpunimin me ndërmarrjen që e ka themeluar. Gjithashtu, vetëm një themelues nuk është i kënaqur me bashkëpunimin me drejtorin e ndërmarrjes publike të themeluar prej tij [tabela 46]

REKOMANDIME

REKOMANDIME

Bazuar në hulumtimin e kryer, mund të nxirren rekomandimet e mëposhtme. Në këtë drejtim është i nevojshëm:

1. Përmirësimi i mjeteve dhe burimeve materiale dhe teknike që janë në dispozicion të personave të autorizuar për pranim të denoncimeve nga denoncuesit.
2. Rritja e numrit të personave të autorizuar për pranim të denoncimeve nga denoncuesit
3. Rritja e numrit të trajnimeve për personat e autorizuar për pranim të denoncimeve nga denoncuesit, si dhe rritja e fondeve për organizimin e trajnimeve për pranim të denoncimeve nga denoncuesit.
4. Krijimi i partneritetit me organizatat e shoqërisë civile dhe organizatat ndërkombëtare me qëllim organizimin e përbashkët të trajnimeve dhe shkëmbimin e përvojave.
5. Monitorimi sistematik i detyrimit për publikimin e të dhënave të personit të autorizuar për pranim të denoncimeve nga denoncuesit në faqen e internetit të institucionit (ndërmarrjes) dhe detyrimit për përgatitjen e raporteve dhe sanksionimin e subjekteve që nuk veprojnë sipas këtij detyrimi.
6. Duke marrë parasysh se janë konstatuar lëshime dhe devijime të ndryshme, por edhe të karakterit parandalues, inkurajohet subjekti kompetent për mbikëqyrje Ministria e Drejtësisë të kryej mbikëqyrje dhe përgatitje të planit për mbikëqyrje të zbatimit të Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve.

7. Vendosja e procedurave të brendshme (veçanërisht në ndërmarrjet e mëdha publike) për njoftimin e të punësuarve me mundësitë për t'u paraqitur si denoncues përmes punëtorive apo trajnimeve apo përmes përgatitjes së udhëzuesve dhe udhëzimeve.
8. Rritja e transparencës dhe llogaridhënies përmes zbatimit të vazhdueshëm të dispozitave ligjore ekzistuese.
9. Publikimi i plotë i informacioneve me karakter publik për të cilin subjekti është përgjegjës në përputhje me nenin 10 të Ligjit për qasje të lirë në informatat me karakter publik.
10. Respektimi i plotë i detyrimit nga neni 18 i Ligjit për qasje të lirë në informatat me karakter publik për dërgimin e kërkesës, veçanërisht në rastet kur personat juridikë janë në cilësi të themeluesit dhe ndërmarrjes.
11. Rritja e mbulimit të politikave dhe dokumenteve kundër korrupsionit si planet vjetore për vlerësimin e rreziqeve të korrupsionit, aktet e brendshme për parandalimin e konfliktit të interesit dhe aktet e brendshme për pranimin e dhuratave.
12. Zbatimi i mjeteve (udhëzues, punëtori, seminare) për njoftimin e të punësuarve me aktet e brendshme kundër korrupsionit.
13. Bashkëpunimi me sektorin e specializuar civil dhe shkëmbimi i përbashkët i përvojave për përgatitjen e akteve të brendshme kundër korrupsionit.
14. Sigurimi i burimeve financiare për punimin e faqes së internetit të ndërmarrjes publike, si parakusht për llogaridhënie dhe transparencë.
15. Publikimi i detyrueshëm i konkurseve për përzgjedhjen e anëtarëve të këshillit drejtues në faqen e internetit të ndërmarrjes.
16. Publikimi i detyrueshëm i biografive të anëtarëve të këshillit drejtues dhe i raporteve për punën e ndërmarrjes në faqen e internetit të ndërmarrjes dhe/ose në faqen e themeluesit.
17. Inkurajimi i këshilltarëve vendorë që të kryejnë funksion mbikëqyrës mbi punën e ndërmarrjeve publike të themeluara nga komuna, përmes institutit për çështje të këshilltarëve.
18. Përfshirja e themeluesit në procedurën për përgatitjen e dokumenteve kundër korrupsionit të ndërmarrjeve publike.

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

334.722:005.332.5(497.7)(047.31)

СПАСЕВСКИ, Дарко

Студија за процена на состојбата за постапување по пријави на
укажувачи и транспарентност и отчетност на јавните претпријатија во
Република Северна Македонија / Дарко Спасевски. - Скопје : Институт за
стратешки истражувања и едукација - ИСИЕ, 2023. - 42,42 стр. : илустр. ;
21 см

ISBN 978-608-66313-9-0

1. Spasevski, Darko: Studim për vlerësim të gjendjes për veprim ndaj
denoncimeve të denoncuesve dhe transparencës dhe llogaridhënies të
ndërmarrjeve publike në Republikën e Maqedonisë së veriut

а) Јавни претпријатија – Транспарентност – Македонија – Истражувања

COBISS.MK-ID 60131589

